

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaDecor®-803 Nature

### SHTRESË NIVELUESE PËR SIKADecor®-801 NATURE MBI MURE

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Llaç me 2 përbërës i modifikuar me polimere, me bazë çimento portland, agregate të përzgjedhura dhe aditivë, për nivelimin e mureve përpara aplikimit të SikaDecor®-801 Nature.

#### PËRDORIMET

Rregullim dhe riprofilizim i sipërfaqes përpara SikaDecor®-801 Nature mbi:

- Beton dhe llaç çimentoje
- Tulla
- Mure me veshje qeramike të vjetra të përgatitura

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Dozë paraprake
- Aplikim i lehtë
- Tkurrje e ulët

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Llaç çimentoje i modifikuar me polimere	
<b>Ambalazhi</b>	Përbërësi A:	bidon 5.0 kg
	Përbërësi B:	thes 25.0 kg
	Përbërësit A + B:	njësi me dozë paraprake 30.0 kg
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Përbërësi A:	lëng ngjyrë qumështi
	Përbërësi B:	pluhur i bardhë
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal të padëmtuar dhe të mbyllur.	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga ngrirja. Të ruhet në kushte të thata.	
<b>Dendësia</b>	Produkti i freskët:	~ 2.0 kg/l

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

### Struktura e sistemit

### Sika® EmotionFloor mbi mure

Sistemi i veshjes	Produkti	Konsumimi
Prajmer (sipërfaqe çimentoje):	SikaTop®-10	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup>
Prajmer (sipërfaqe gipsi):	SikaTop®-50	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup>
Nivelimi <sup>1)</sup> :	SikaDecor®-803 Nature	~ 2.0 kg/m <sup>2</sup> /mm
Shtresë dekoruese:	2 - 3 x SikaDecor®-801 Nature	~ 0.35 - 0.45 kg/m <sup>2</sup> /shtresë
Shtresë e 1-rë izoluese:	Sikafloor®-304 W + 20 % ujë	~ 0.1 kg/m <sup>2</sup>
Shtresë e 2-të izoluese:	Sikafloor®-304 W + 5 - 10 % ujë	~ 0.1 kg/m <sup>2</sup>

<sup>1)</sup> Mbi gips apo sipërfaqe të lëmuar mund të nevojitet nivelim. Por, konsumimi i shtresës së 1-rë të SikaDecor®-801 Nature shtohet deri në 1.5 kg/m<sup>2</sup>.

Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firos, etj.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : B =	5 kg : 25 kg
Konsumimi	~ 2.0 kg/m <sup>2</sup> /mm	
Temperatura e mjedisit	Min. +8 °C, max. +30 °C	
Temperatura e nënshtresës	Min. +8 °C, max. +30 °C	
Koha e pritjes / mbiveshja	Mund të bluhet pas:	~ 5 - 8 orësh (+23 °C), në varësi të lagështisë relative të ajrit. Mund të bluhet sapo SikaDecor®-803 Nature të jetë mjaftueshëm i fortë.

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa nuk duhet të ketë pluhur, materiale të lira, kontaminues të sipërfaqes si vaj, graso, veshje të vjetra.

Përdorni prajmer të përshtatshëm.

Nëse aplikohet mbi pllaka të vjetra qeramike, këto duhet të jenë të ngjitura mirë mbi nënshtresë dhe të bluara.

Kryeni provë në rast dyshimi.

### PËRZIERJA

Përzieni mirë përbërësin A (lëng i bardhë) derisa të jetë homogjen. Hidheni brenda një ene të përshtatshme dhe shtoni gradualisht përbërësin B (pluhur), ndërsa përzieni me mikserin elektrik. Përzieni për të paktën 2 minuta, derisa miksi të jetë homogjen dhe pa kokrriza.

Rekomandohet një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (~ 300 - 400 rpm).

### APLIKIMI

Aplikoni SikaDecor®-803 Nature e përzierë mbi nënshtresë me mallë në trashësinë e dëshiruar. Midis shtresave të SikaDecor, sipërfaqja duhet të laget paraprakisht deri në saturim.

Sigurohuni se prajmeri i përdorur (SikaTop®-10, SikaTop®-50) është ende i ngjithshëm gjatë aplikimit të llaçit riprofilizues ("i lagësht mbi të lagësht").

Aplikimi i llaçit duhet bërë duke e ngjeshur mirë mbi nënshtresë. Sapo produkti të jetë ngurtësuar është e mundur bluarja e sipërfaqes.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

Gjatë aplikimit dhe procesit të trajtimit, temperatura duhet të rrijë mbi +8°C.

Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura.

Mos hidhni ujë shtesë gjatë nivelimit të sipërfaqes së përfunduar, pasi mund të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje.

Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja, era dhe veprimi i drejtpërdrejtë i diellit.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaDecor®-803 Nature

Mars 2019, Botimi 02.01

020815030010000029

SikaDecor-803Nature-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf